D E K R E T
Nr.1419, datë 20.3.1996

PËR FARAT DHE FIDANET

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7659, datë 12.1.1993 "Për farat dhe fidanët", pas nenit 9 shtohet neni 9/a me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht nga sa më sipër, për raste të mungesës së prodhimit vendas a të fatkeqësive natyrore, me miratim të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, lejohet importimi dhe tregtimi i kultivarëve, hibrideve, farave dhe fidanëve që nuk janë të regjistruar në regjistrin themeltar shqiptar, por janë të regjistruar e certifikuar në vendet prej të cilave vijnë".

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 3

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohet.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha